



FOTO: AGJENCIA RAJONALE E ZHVILLIMIT PËR BJELASICË, KOMOVI DHE PROKLETIJE-
PROJEKTI RUAJTJA E PEISAZHEVE KULTURORE NË SHOIPËRI DHE MAL TË ZI

PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT - BULETINI

IPA Programeve të Bashkëpunimit
ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri dhe
Mali i Zi - Kosovë 2014- 2020

Dhjetor 2018

PËRMBAJTJA

Edicioni i tretë i buletinit të programeve IPA BNK MZ-SHQ dhe MZ-KS

Edicioni i tretë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi - Kosovë* 2014-2020.

Më shumë informacione për programet mund t'i gjeni më poshtë.

Programi IPA i BNK Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA i BNK-së Mali i Zi-Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 dhe nuk paraqet domodoshmerisht mendimet e Bashkimit Evropian.

© 2018 IPA Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi - Kosovë

- » Konferenca solemne për projektet e përzgjedhura për financim në kuadër të IPA Programit të BNK Mali i Zi – Kosovë 2014-2020.....2
- » Trajnimet dhe punëtoritë e organizuara për aplikues potencial të IPA Programit BNK Mali i Zi – Kosovë.....3
- » Instrumenti për kërkimit e project partnerëve.....3
- » Projektet e financuara në kuadër të thirrjes së parë për projekt propozime të programit IPA BNK Mali i Zi – Kosovë 2014-2020.....4
- » Takime të organizuara në kuadër të programeve IPA BNK MZ-SHQ dhe MZ-KS 2014 – 2020.....6
- » Aktivitete për ngjirjen e kapaciteteve të përfuturësive të granteve.....7
- » Ditët informuese/Forumet për kërkimin e partnerëve për projekte për aplikues potencial.....7
- » Programi i punës për Grantet i programit IPA BNK Mali i Zi – Kosovë7
- » Të reja nga projektet e financuara në kuadrin e Thirres së I të IPA Programit BNK Mali i Zi – Shqipëri.....9

*Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian



MNE - ALB

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI 2014-2020



MNE - KOS

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020

Konferenca solemne për projektet e përzgjedhura për financim në kuadër të IPA Programit të BNK Mali i Zi - Kosovë 2014-2020

Fillimi i zbatimit të gjashtë projekteve të përzgjedhura në kuadër të Thirrjes së Parë për Projekt-propozime për Programin IPA të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 është zyrtarizuar në mënyrë ceremonijale me 16 nëntor të vitit 2018 në Prishtinë.

Udhëheqësja e Strukturës operative në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, **Rozafa Ukimeraj**, i përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit e ngjarjes dhe deklaroi se ka qenë interesim i madh i aplikantëve potencial që kanë aplikuar në thirrjen e hapur si dhe falënderoi përfituesit e granteve për përkushtim dhe arritje. Njëkohësisht, ajo ftoi të gjitha institucionet lokale dhe qendrore, komunat dhe organizatat e shoqërisë civile për t'u angazhuar më tej në periudhën e ardhshme, pasi që shpallja e Thirrjes së dytë për projekt – propozime është planifikuar të jetë së shpejti.



Shefi i Departamentit për Bashkëpunimin Territorial Evropian në Zyrën e Integritimit Evropian të Malit të Zi, **Miodrag Raçeta** shprehu kënaqësinë e tij për faktin se për herë të parë në kuadrin e këtij Programi që strukturat operative po shpallin kontraktimin dhe zbatimin e projekteve në menaxhimin indirekt, që është rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm të krijuar nga të dy vendet që kanë në perspektivën e tyre. Ai përkujtoi se nga 8.4 milion euro që ishin në dispozicion për këto shtete për periudhën 2014 – 2020, për këtë Thirrje ishin dedikuar 2.04 milion euro.

Ai shprehu bindjen se aktivitetet e projekteve do të kontribuojnë në fuqizimin e nxitjes së punësimit në zonën e programit, përmirësimin e qasjes dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore, krijimit të parakushteve teknike për menaxhimin e integruar të mbeturinave të ngurta dhe valorizimin e potencialeve të përbashkëta të



turizmit bazuar në trashëgiminë e përbashkët natyrore dhe kulturore.

Numri i partnerëve




Shefi i Drejtorisë për Kontrollin e Cilësisë në Drejtorinë për Financimin dhe Kontraktimin e Fondeve të Asistencës së BE-së në Ministrinë e Financave të Malit të Zi, **Lluka Gjuriçkoviç**, tha se financimi i projekteve të përzgjedhura në këtë thirrje do të kontribuojnë në realizimin e objektivave të Programit dhe se realizimi i tyre përfshin angazhimin e përbashkët të shumë institucioneve dhe organizatave. Ai gjithashtu rikujtoj faktin se vlera e projekteve të kontraktuara do të jetë 2.02 milion euro, që paraqet 99% të shumës që ishin në dispozicion sipas Thirrjes së Parë.

Zëvendës shefi i Sektorit për Bashkëpunim në Zyrën e BE-së në Kosovë, **Libor Chlad**, tha se përmes programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, Bashkimi Evropian e shih si mundësi që të lidhë vendet dhe interesin e përbashkët të njerëzve që jetojnë në zonën kufitare, jo vetëm përmes krijimit të

mundësive për këtë popullsi, por edhe përmes bashkëpunimit të ngushtë dhe krijimit të partneriteteve. Ai shprehu shpresë se projektet do të zbatohen jo vetëm në përputhje me rregullat e vendosura, por edhe në përputhje me interesat dhe përfitimet e njerëzve që jetojnë në rajonet kufitare.

Kontraktuar për Prioritet Tematik



Pas fjalëve hyrëse, **Sanja Todoroviç**, Udhëheqëse e Sekretariatit të Përbashkët Teknik paraqiti shkurtimisht objektivat e Thirrjes së Parë, pas së cilës përfituesit e granteve të kontraktuara paraqitën aktivitetet që do të zbatohen në periudhën e ardhshme. Në konferencë morën pjesë mbi 70 përfaqësues të institucioneve relevante dhe komunave nga Mali i Zi dhe Kosova, përfaqësues të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, ambasadorë, përfaqësues të projekteve të kontraktuara në kuadër të kësaj thirrje, si dhe përfaqësues të sektorit civil dhe mediave.

Trajnimet dhe punëtoritë e organizuara për aplikues potencial të IPA Programit BNK Mali i Zi - Kosovë

Sekretariati i Përbashkët Teknik i IPA programeve të bashkëpunimit ndërkufitarë Mali i Zi- Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë, në bashkëpunim me Zyrën për Integritim Evropian të Malit të Zi, Ministrinë e Financave në Mal të Zi – Drejtorinë për Financimin dhe Kontraktimin e Asistencës së BE-së (CFCU) dhe Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, ka organizuar trajnime dhe punëtori si pjesë e aktiviteteve para shpalljes së Thirrjes së Dytë për projekt-propozimet në kuadër të IPA programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë 2014 – 2020.



Trajnimet mbi ciklin e menaxhimit të projekteve janë mbajtur në Gjakovë (Kosovë) në intervalin 23-25 tetorë dhe në Berane (Mal i Zi) në periudhën 30 tetor – 1 nëntor të vitit 2018. Qëllimi i këtyre trajnimeve tre-ditore ishte të iu mundësojnë pjesëmarrësve të mësojnë mbi elementet thelbësore dhe të marrin informatat e nevojshme për kuptimin e procesit të përgaditjes së projekteve, partneritetit ndërkufitarë dhe procesit të hartimit të projekt propozimit në përshatëshmëri me qasjen e kornizës logjike. Evenimentet ofronin mundësinë që pjesëmarrësit të përmes punës praktike,



shembujve, diskutimit në grupe, si dhe përmes pyetjeve dhe përgjigjeve mbi bazat themelore lidhur me ciklin e menaxhimit të projekteve. Në trajnime morën pjesë 41 përfaqësues të të kategorive të ndryme të aplikuesve potencial nga zona e programit.



Punëtorit (klinikat) janë mbajtur në Gjakovë (Kosovë) me 26 tetorë dhe në Berane (Mal i Zi) me 2 nëntorë të vitit 2018. Qëllimi i punëtorive ishte të përmirësojë kapacitetet e

Përdorni Instrumentin e Kërkimit të Partnerëve për të gjetur partnerin tuaj të ardhshëm në projekt

Jeni duke kërkuar partner për një projekt të ri në kuadër të programit IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri ose programit IPA BNK Mali i Zi – Kosovë 2014-2020? Instrumenti ynë për kërkimin e partnerëve është i disponueshëm t'ju asistojë për gjetjen e partnerëve. Ju lutemi që të plotësoni formularin e kërkimit të partnerit dhe publikoni informacionin në bazën tonë të të dhënave në mënyrë partnerët e tjerë të interesuar të kenë mundësinë të ju kontaktojnë.

Klikoni [këtu](#) për qasje tek instrumenti për programin IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri 2014 - 2020.

Klikoni [këtu](#) për qasje tek instrumenti për programin IPA BNK Mali i Zi - Kosovë 2014-2020.

aplikuesve potencialë, sidomos të atyre që nuk ishin të sukseshëm në kuadër të thirrjes së parë për projekt-propozime në Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Mali i Zi – Kosovë 2014-2020, lidhur me procesin e përgatitjes së projekt-propozimeve. Po ashtu, atyre ju dhanë rekomandime mbi rregullimin/tejkalimin e gabimeve të zakonshme brenda seksioneve të ndryshme të aplikimit. Në evenimentet e organizuar morën pjesë mbi 40 pjesëmarrës.



FAKTE TË SHPEJTA – PROGRAMI IPA BNK MZ-SHO DHE MZ-KOS 2014-2020

Strutura Operuese në Malin e Zi është e vendosur brenda Qeverisë së Malit të Zi – Zyra për Integritim Evropian (njësia BNK) dhe Ministria e Financës (Autoriteti Kontraktues).

Strutura Operuese në Shqipëri është Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Strutura Operuese në Kosovë është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal



PROJEKTET E FINANCUARA NË KUADËR TË THIRRJES SË PARE PËR PROJEKT PROPOZIME TË PROGRAMIT IPA BNK MAL I ZI – KOSOVË 2014-2020

Kontraktimi i projekteve të financuar nën Thirrjen e Parë në kuadër të të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë u përmbyll në periudhën tetor - dhjetor të vitit 2018. Konkretisht, për të tre prioritetet tematike të programit që mbulojnë promovimin e punësimit, lëvizshmëria e krahut/ofertës së punës dhe përfshirjes kulturore dhe sociale përgjatë kufirit, mbrojtjen e mjedisit, promovimin e ndryshimeve klimatike dhe masave për zbutjen e tyre, menaxhimin dhe parandalimin e rreziqeve, si dhe inkurajimin e turizmit, trashigimisë kulturore dhe natyrore, u kontraktuan 7 projekte:

- »» Bjeshkët e Nemuna – destinacion natyror tërheqës;
- »» CARES – Veprimet ndërkufitare në sektorin e shëndetit riprodhues;
- »» Nisma të përbashkëta ndërkufitare për menaxhim më të mirë të mbeturinave;
- »» Aktivitetet ekologjike dhe të turizmit në natyrë në Alpet Ballkanike;
- »» Punë në sektorin bujqësor për një të ardhme më të mirë të rajonit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Kosovës;
- »» Të bashkuar kundër ndotjes – UAP;
- »» Vetëpunësimi i të rinjve dhe sipërmarrjet sociale.

FAKTE – THIRRJA 1-rë PROGRAMI IPA BNK MZ-KS 2014-2020

Aplikuesit potencial në thirrjen e Parë për projekte kërkuar **10** herë më shumë fonde për projektet **(1004%)** e tyre krahasuar me fondet e vëna në dispozicion.

Bjeshkët e Nemuna - destinacion natyror tërheqës

Ky projekt zbatohet nga Agjencia Rajonale e Zhvillimit Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije në bashkpunim me Organizatën Turistike të Plavës, Agjencinë e Zhvillimit Rajonal - Perëndimi (AZHR-Perëndim) dhe Komunën e Pejës.

Aktivitetet synojnë të kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të zonës së Bjeshkëve të Nemura si një destinacioni turistik, të

përmirsojnë infrastrukturën turistike dhe të rrisin dukshmërinë e të gjithë zonës së synuar.

Kohëzgjatja e projektit është 18 muaj dhe rezultatet e parashikuara përfshijnë përmirësimin e infrastrukturës së turizmit në



natyre, standardizimin e informatave ndërkufitare të cilat do të jenë në dispozicion turistëve dhe agjensive turistike, si dhe promovimin e zonës së synuar si një destinacion atraktiv natyror. Grupet e synuara të projektit janë bizneset, sektori qeveritar, organizatat turistike në Deçan, Andrijevicë, Berane and Rozhajë, si dhe autoritet lokale në territorin e synuar nga projekti, duke përfshi edhe zonat e mbrojtura Prokletije/Bjeshkët e Nemuna, dhe parkun rajonal natyror Komovi. Aktivitetet e parashikuara do të zbatohen në komunat e Pejës dhe Deçanit në Kosovë dhe në komunat e Plavës, Gucisë, Andrijevicës, Beranës dhe Rozhajës në Mal të Zi.



Pë më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

CARES - Veprimet ndërkufitare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues

Në bashkpunim me njëri-tjetrin, FORS

Montenegro dhe ECMI Kosovë – (Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave) do të zbatojnë projektin që në fokus të aktiviteteve të vet ka shëndetin dhe mirëqënien nëpërmjet përmirësimit të shëndetit riprodhues të grave në zonën e synuar, përmirësimit të cilësisë së shërbimeve shëndetsore, rritjes së vetëdijes për rëndësinë e kontrolleve të rregullta preventive dhe krijimit të shprehisë së parandalimit.



Foto: Bashkëpunimi ndërkufitar evropian për shëndetin: Teoria dhe praktika

Projekti që do zbatohet në 14 komuna (Andrijevicë, Berane, BijeloPolje, Guci, Petnjicë, Plavë, Kolashin, Mojkovac and Rozhajë në Mal të Zi dhe Pejë, Istog, Klinë,

Deçan dhe Gjakovë në Kosovë) ka si grup të synuar gratë e këtyre zonave, gratë e papunësuar, gratë që u përkasin pakicave, gratë nga zona rurale, OJQ-të që merren me çështjen e grave, gratë e reja dhe rininë, si dhe qendrat shëndetsore dhe të punësuarit e tyre.

Rezultatet e pritshme brenda 18 muajve të zbatimit të projektit, janë: përmirësimi i kapaciteteve të qendrave shëndetësore dhe cilësisë së shërbimeve të shëndetit riprodhues; ngritja e vetëdijes lidhur me rëndësinë e mbrojtjes së shëndetit riprodhues, veçanërisht për grupet e rrezikuara sociale; realizimi i fushatës së ekzaminimeve të organizuara parandaluese; përmirësimi i shëndetit riprodhues.

Pë më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

Iniciativa të përbashkëta ndër-kufitare për menaxhim më të mirë të mbeturinave

Me qëllim të përmirësimit të kushteve mjedisore në zonën ndërkufitare, nëpërmjet edukimit dhe mbështetjes teknike për menaxhimin e mbetjeve, ndërmarrja e Shërbimeve komunale Plavë në Malin e Zi dhe Kompania Regjionale e Mbeturinave Çabrat – Gjakovë në Kosovë do bashkëpunojnë gjatë 18 muajve të zbatimit të projektit që do zbatohet në komunat e Plavës dhe Gjakovës. Projekti do fokusohet tek të punësuarit e sektorit publik, qytetarët e komunave të Plavës dhe Gjakovës, si dhe turistët e këtyre zonave.



Gjatë zbatimit të këtij projekti, partnerët do të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik të zonës ndërkufitare nëpërmjet valorizimit efikas të mbeturinave. Gjithashtu ata do të krijojnë një sistem të mbledhjes dhe trajtimit selektiv të mbeturinave në zonën urbane të komunës së Gjakovës dhe Plavës, duke përfshirë edhe krijimin e parakushteve teknike për menaxhimin e integruar të mbetëzrinave. Gjithashtu, ata do të angazhohen në procesin e edukimit të vazhdueshëm të aktorëve kyç për menaxhimin e integruar të mbeturinave.

Pë më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

Aktivitetet ekologjike dhe të turizmit në natyrë në Alpet Ballkanike

Qendra për Mbrojtjen dhe Huluntimin e Zogjve në bashkëpunim me Shërbimin e Shpëtimit malor të Malit të Zi dhe Qendrën Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC) dhe Shoqërinë Bjeshkatore Alpiniste "Pashtriku" kanë filluar zbatimin e projektit i cili do të valorizojë efektivisht eksperiencat kulturore dhe natyrore autentike në Alpet Ballkanike si pjesë e sektorit turizmit të qendrueshëm në nivel ndërkufitar.

Parku Kombëtarë Prokletije (Mal i Zi) dhe Parku Kombëtarë Bjeshkët e Nemuna (Kosovë), duke përfshirë rajonin ndërmjet bashkive Deçan (Kosovë) dhe Plavë (Mal i Zi) do të pasurohen me cilësinë dhe dukshmërinë e ofertave të shërbimeve aktive turistike, si dhe nëpërmjet rritjes së sigurisë së turistëve në zonat malore. Për më tepër, zonat me vlera natyrore do të mbrohen, revitalizohen dhe do të hapen për publikun.

FAKTE –TURIZMI NË NATYRË

Ky term i referohet aktiviteteve turistike jashtë ambienteve të mbyllura, shpesh në natyrë ose mjedisve gjysëm natyrore jashtë qendrave të banuara.

Aktivitetet e parashikuara të zbatohen gjatë 24 muajve, synojnë ofruesit e ofertave turistike siç janë organizatat turistike lokale, operatorët turistik, ciceronët, administratorët/mbikëqyrësit e parqeve kombëtare, shoqatat e bjeshkatarëve dhe shërbimet e shpëtimit malor, komunitetin lokal dhe ofruesit e shërbimeve akomoduese, vizitorët, autoritetet lokale dhe OJQ-të.

Pë më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

Punë në sektorin bujqësor për një të ardhme më të mirë të rajonit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Kosovës

Komuna Andrijevicë në bashkëpunim me Unionin e fermerëve të Veriut të Mali të Zi, OJQ Grupi Lokal i Veprimt "Gjeravica" dhe Fondi Lokal i Zhvillimit në Kosovë, do të zbatojnë një projekt 18 mujor që synon të forcojë sektorin bujqësor në rajonin ndërkufitar nëpërmjet përmirësimit të

aftësive që do nxisë punësimin në sektorin e synuar.

CITATE – PUNË TË GJELBËRTA

"Punë të gjelbërta janë aktivitete të përshtatshme që kontribuojnë në ruajtjen dhe restaurimin e ambientit, qofshin ato në sektorin tradicional si industria apo ndërtimi ose nga sektorët e rinj, si energjia e rinovueshme dhe efizienz energjitike – Organizata Ndërkombëtare e Punës

Fermerët, të rinjtë dhe gratë nga komuna Deçan në Kosovë dhe komunat Andrijevicë, Berane dhe Plavë në Mal të Zi, kanë mundësinë të përmirësojnë kapacitetet teknike bujqësore, të promovojnë produktet e tyre bujqësore nga rajoni ndërkufitar tek publiku dhe bizneset, si dhe të punësojnë në sektorin bujqësorë bazuar në identifikimin dhe promovimin e burimeve të punësimit në këtë fushë.

Pë më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

Të bashkuar kundër ndotjes - UAP

Komuna e Gjakovës në bashkëpunim me "Let's Do It Peja" në Kosovë dhe komunën e Petnjicës dhe Qendrën për Zhvillim Rajonal – Rozhajë në Mal të Zi po zbatojnë një projekt që do zgjasë 24 muaj dhe që ka në fokus banorët që jetojnë pranë deponive të paligjshme, autoritetet lokale, të punësuarit në fushën menaxhimit të mbeturinave dhe studentët nga komunat e Gjakovës dhe Petnjicës.



United Against Pollution

Qëllimi i këtij projekti është që të krijojë mjedisi më të sigurtë dhe më të pastër për të gjithë komunitetin, të përmirësojë shëndet fizik dhe gjendjen ekonomike të rajonit ndërkufitar, të ngisë vetëdijen e banorëve mbi rreziqet nga doponitë e paligjshme dhe mbi atë se si mund t'i zvogëlojnë ato rreziqe duke marrë pjesë në sistemin e mbledhjes dhe menaxhimit të mbeturinave, si dhe ndërgjegjen e studenteve mbi mundësitë e zhvillimit ekonomik dhe mbi zvogëlimin e

rrezikut të shëndetit me ndihmën e mbrojtjes së mjedisit.

Aktivitetet e projektit do të rezultojnë në krijimin e dialogut ndërmejt banorëve, zyrtarëve lokal dhe të rinjve dhe rritjen e ndërgjegjësimit të mbi rrezikun e deponive të paligjshme. Kjo do të thotë se do të ngritët vetëdija e banorëve për rrezikun nga mbeturinat e paligjshme, si të marrin pjesë në sistemin e mbledhjes lokale të mbeturinave dhe si të raportojnë shkelësit e ligjit. Gjithashtu autoritet lokale dhe kompanitë publike do njohtohen me praktikat më të mira. Poashtu, do të bëhen përmirësime tek stacionet transferuese të mbetjeve, pastrimi dhe monitorimi i zonave të ndotura dhe gjelbërimi i tyre. Për më tepër, do ofrohen trajnime për punonjësit dhe masat paraprake për shpëtimin e tyre do përmirsohen, përfshirë këtu edhe njohjen me praktikat më të mira.

Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

Vetëpunësimi i të rinjve dhe sipërmarrjet sociale

Udhëheqësi i projektit Asociacioni për Prosperitet Demokratik – Zid nga Mali i Zi në bashkëpunim me partnerët e tij Qendër për aftësi kreative nga Mali i Zi dhe OJQ Lens dhe Qendren Liberale Demokratike nga Kosova zbatojnë këtë projekt 24 mujor që do merret me të rinjtë e papunësuar dhe prindrit e tyre nga Mali i Zi dhe Kosova. Zonat e synuara janë komunat Pejë, Istok dhe Deçan në Kosovë dhe komunat e Podgoricës, Rozhajës dhe Beranes në Mal të Zi.

CITATE – SIPËRMARRJE SOCIALE

*Sipërmarrja sociale është...
Arti i "ndjekjes së bashkrenduar të kthimit të investimit në terma financiar dhe social (linjë e dyfishtë)." - Instituti për Sipërmarrjen Sociale*

Nëpërmjet aktiviteteve të tij, projekti synon të arrij rezultate që përfshijnë informimin dhe inkurajimin e të rinjve nga rajoni ndërkufitar për përdorimin e teknologjive dhe inovacioneve social si një mundësi për punësim. Gjithashtu, ato do të ofrojnë trajnime dhe asistencë personale për rritjen e aftësive dhe kompetencave në mbështetje të zhvillimit të mundësive për hapjen e bizneseve të tyre, si dhe mbështetjen e të rinjve për shkëmbimin e ideve dhe fillimin e bashkëpunimit të bizneseve ndërmejt të rinjve nga rajoni ndërkufitar. Qëllimi i projektit është të përmirësoj tregun e punës për të rinjtë dhe të inkurajoj grupet e rrezikuara sociale që të jenë pjesë e shoqërisë nëpërmjet promovimit të

metodologjive dhe mjeteve të cilat do të përmirësojnë aftësitë, kompetencat dhe në shkëmbimin e ideve dhe bizneseve ndërkufitar ndërmjet të rinjve nga rajoni.

Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

Gjegjësisht, gjatë ditës së parë të takimit është prezantuar lista e projekteve të propozuara për financim në kuadër të Thirrjes së Parë për dërgimin e projekt-propozimeve. Komiteti i Përbashkët i Monitorimit dhe një



Takime të organizuara në kuadër të programeve IPA BNK MZ-SHQ dhe MZ-KS 2014 - 2020

Komiteti i Përbashkët Monitorues i Programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë 2014 - 2020 mbajti takimin e Tretë

Takimi i Tretë i Komitetit të Përbashkët Monitorues në kuadër të programit IPA të bashkëpunimit ndërkufitarë Mal i Zi – Kosovë 2014 – 2020 u mbajt me datë 25 dhe 26 shtator të vitit 2018 në Prishtinë.



Në takim morën pjesë përfaqësuesit e strukturave operative të programit (SO), Autoritetit Kontraktues (AK), Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT), si dhe përfaqësuesja e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Malin e Zi në rolin e vëzhguesit.

mendim këshillues pozitiv mbi listën e projekteve të propozuara për financim në kuadër të Thirrjes së Parë me rekomandime shitesë për zbatimin e tyre.



During the second day of the Joint Monitoring Gjatë ditës së dytë të takimit të Komitetit të Përbashkët të Monitorimit u prezantua analiza e rezultateve që do të arrihen me ndihmën e projekteve të propozuara për kontraktim brenda Thirrjes së Parë dhe u vlerësua kontributi i tyre në arritjen e indikatorëve të programit. Përfaqësuesit e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit u pajtuan që thirrja tjetër të fokusohet dhe propozuan prioritetet tematike, qëllimet specifike dhe grupet e synuara që do të mbulohen në Thirrjen e Dytë për dërgimin e projekt-propozimeve.

Shihni Programin e Punës më poshtë



Aktivite për ngritjen e kapaciteteve të përfituesëve të granteve

Si pjesë e aktiviteteve për përfundimin e kapaciteteve të përfituesëve të granteve, Sturkutat operative të Programit, Autoriteti Kontraktues (CFCU), Zyra për Integrimin Europian të Malit të Zi, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës dhe Sekretariati i Përbashkët Teknik për IPA Programet të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014 – 2020 (SPT), kanë organizuar një sërë trajnimesh për ngritjen e kapaciteteve të përfituesëve nga Thirjes së parë në kuadër të IPA Programit të bashkëpunimit ndërkufitarë Mali i Zi – Kosovë 2014-2020.

Trajnimi mbi zbatimin e projekteve

Trajnimi mbi zbatimin e projekteve u mbajt më 22 të vitit 2018 në Podgoricë dhe u zbatoi nga CFCU nën mbështetjen teknike të SPT-së. Qëllimi i trajnimit ishte që përfituesve të granteve t'iu jap informacione themelore mbi rolin dhe përgjegjësitë e përfituesve të granteve në lidhje me detyrimet kontraktuale dhe anekset e kontratës, menaxhimin financiar dhe arkivat, modifikimin e kontratës, si dhe mbi aspektet kryesore të raportimit, monitorimit, kontrollit dhe vizibilitetit. Në trajnim morën pjesë aktive 29 pjesëmarrës, të cilët ngritën dhe hapen disa pyetje dhe çështje me të cilat ata mund të ballafaqohen gjatë procesit të zbatimit të projektit.



Trajnimi mbi prokurimin sekondar

Trajnimi mbi prokurimin sekondar u mbajt më 23 nëntor të vitit 2018 në Podgoricë. Ai u zbatoi nga CFCU nën mbështetjen teknike të SPT-së, me qëllimi të dhënies së informacioneve përfituesëve të granteve mbi parimet e prokurimeve, përgatitjes së dokumentacionit të prokurimeve dhe informacione mbi tenderin e thjeshtë dhe procedurës konkurruese me negocim.

Trajnimi kishte 29 pjesëmarrës.

Trajnimi mbi temën e raportimit

Trajnimi mbi temën e raportimit është mbajtur me 12 dhejtor të vitit 2018 në Pejë (Kosovë) dhe është zbatuar nga SPT-ja. Në trajnim morën pjesë 16 përfitues të granteve nga thirrja e parë në kuadër të këtij programi, të cilëve iu janë dhënë informata të detajuara lidhur mbi elementet kryesore të raportimit, duke iu mundësuar atyre të kuptojnë dhe të mësojnë në tërësi mbi konceptin e raportimit.

Poashtu, ato morën udhëzime se si duhen plotësuar pjesët narrative dhe financiare të raportit.



Trajnimi mbi temën e publicitetit dhe vizibilitetit

Në trajnimi mbi temën e publicitetit dhe vizibilitetit, i cili është mbajtur me 13 dhejtor të vitit 2018 në Pejë (Kosovë), morën pjesë 16 përfitues të granteve nga thirrja e parë në kuadër të këtij programi.

Qëllimi i trajnimit, i cili është zbatuar nga SPT-ja, ishte të jap informacione mbi përdorimin e duhur të metodave dhe teknikave për publicitet dhe vizibilitet në përputhje me procedurat dhe rregullat e BE-së, si dhe të jap rekomandime dhe sugjerime se si të sigurohet vizibiliteti i donatorit dhe si të përdoren mjetet e komunikimit me qëllim të informimit të publikut lidhur me projektet ndërkufitare.



PROGRAMI I PUNËS PËR GRANTE - IPA BNK MAL I ZI - KOSOVË 2014-2020 ËSHTË PUBLIKUAR

Programi i punës për grante në Mal të Zi, i cili është prezantuar nga Ministria e Financave në Mal të Zi, përkatësisht nga Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e Asistencës së BE-së, për programin e bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi - Kosovë 2014 – 2020 në kuadër të Instrumentit për para-aderim 2014-2020 (IPA II) për thirrjen e dytë për projekt-propozime është shpallur dhe mund ta shkarkoni në linkun më poshtë:

WORK PROGRAMME

Programi i punës për grante parashikon dy prioritete tematike (TP), të cilët do të përfshihen brenda thirrjes së dytë për projekt-propozime: **PT1: Promovimi i punësimit, lëvizshmëria e krahut/ofertës së punës dhe përfshirjes kulturore dhe sociale përmes kufirit; PT3: Inkurajimi i Turizmit, Kulturës dhe Trashigimisë Natyrore;**

Shuma totale indikative e cila do të jetë në dispozicion në kuadër të thirrjes së dytë për projekt-propozime është 2,040,000.00 € (me bashkimin e IPA alokimeve financiare për vitin 2016 me vlerë prej 1,200,000.00 € dhe për vitin 2017 me vlerë prej 840,000.00 €)

Shpallja e thirrjes së dytë për projekt-propozime është planifikuar për tremujorin e parë të vitit 2019.

Ditët informuese/Forumet për kërkimin e partnerëve për projekte për aplikues potencial

Gjatë muajëve nëntor dhe dhjetor të vitit 2018, Sekretariati i Përbashkët Teknik i IPA Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 (SPT) në bashkëpunim me Strukturat Operative të të dy programeve ka organizuar disa aktivitete para publikimit të Thirrjes së Dytë për dërgimin e projekt-propozimeve në kuadër të IPA Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020.

Ditët informuese/Forumet për kërkimin e partnerëve organizuar në Shkodër dhe Podgoricë

SPT-ja në bashkëpunim me Strukturat Operative të dy vendeve, Zyren për Integrimin Evropian të Malit të Zi, Autoritetin kontraktues (CFCU) dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, kanë organizuar Ditët informuese/Forumet për kërkimin e partnerëve në Shkodër (Shqipëri) dhe Podgoricë (Mal i Zi).



Qëllimi i ngjarjeve, të organizuara me 6 nëntor në Shkodër dhe 9 nëntor të vitit 2018 në Podgoricë, ishte informimi i pjesëmarrësve rreth IPA Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mal i Zi – Shqipëri 2014-2020, parimeve të bashkëpunimit ndërkufitar dhe përmbajtjes së përgjithshme të paketës së aplikimit.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të themelojnë partneritete, si dhe të ndajnë dhe të këmbëjnë idetë e projektit në kuadër të dy prioritetëve tematike që do të mbulojnë në Thirrjen e Dytë për projekt-propozime: *Mbrojtja e mjedisit, promovimi i ndryshimeve klimatike dhe masave për zbutjen e tij, menaxhimi dhe parandalimi i rreziqeve; Promovimi i punësimit, lëvizshmëria e krahut/ofertës së punës dhe përfshirjes kulturore dhe sociale përmes kufirit.*

Në këtë aktivitet morën pjesë gjithësejt 142 përfaqësues të komunave, organizatave jo-qeveritare, institucioneve arsimore dhe institucioneve tjera nga të dy vendet.



Dita informuese/Forumit për kërkimin e partnerëve organizuar në Pejë

Zyra për Integrimin Evropian, Autoriteti kontraktues (CFCU), Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal e Republikës së Kosovës dhe SPT-ja kanë organizuar Ditën informuese/Forumit për kërkimin e partnerëve në Pejë (Kosovë).

Qëllimi i evenimentit, të organizuar me datë 27 dhjetor të vitit 2018 në Pejë (Kosovë), ishte informimi mbi IPA Programin të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mal i Zi – Kosovë 2014-2020 dhe mbi përmbajtjen e përgjithshme të paketës së aplikimit, duke iu mundësuar aplikuesve potencial të formojnë partneritetet dhe të këmbëjnë idetë e projekteve.



Të pranishmit morën pjesë aktive në punëtoritë tematike, të cilat ishin dedikuar prioritetëve tematike që do të mbulojnë në Thirrjen e Dytë për projekt-propozime: *Promovimi i punësimit, mobilitetit të punës dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përgjatë kufirit; Inkurajimi i Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore.*



Në këtë aktivitet morën pjesë gjithësejt 51 përfaqësues të komunave, organizatave jo-qeveritare, institucioneve arsimore dhe institucioneve tjera nga të dy vendet.



Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e Parë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

Hulumtimet në terren në rajonin ndërkufitar

Stafi i projektit "Ana Femërore e Cilësisë" organizuan hulumtime në terren në rajonin e synuar për të mbledhur detaje dhe informacione të përditësuar mbi gjëndjen aktuale dhe identifikimin e grave kandidate nga familjet rurale.

Partnerët e projektit bashkpunuan me përfaqësuesit e komuniteteve lokale, bënë takime me aktorë të rëndësishëm siç është Zyra për Zhvillimin Rural, shoqatat e Bizneseve, Agjensitë e Punësimit dhe grate kandidate. U mbledhën informacione të dobishme nga të gjithë aktorët mbi nivelin e edukimit të grave, aftësitë dhe kapacitetet ekzistuese, prodhimin bujqësor të cilët së bashku ndihmuan stafin e projektit të përgatisë dhe hartojë programin e edukimit profesional në mënyrë që t'i përgjigjet nevojave dhe vështirësive me të cilat gratë ndeshen.



Projekti "Ishujt e Gjelbër" organizoj trajnime për menaxhimin e mbeturinave

On December 3rd and 4th 2018, the first cross-Në datë 3 dhe 4 dhjetor të vitit 2018, në kuadër të projektit "Ishujt e Gjelbër", u mbajt trajnimi i parë ndërkufitar në Shkodër, ku morën pjesë 40 përfaqësues nga institucionet publike dhe OJC-të nga komunat Berane (Mal i Zi) dhe Malësi e Madhe (Shqipëri). Trajnimi u fokusua tek menaxhimi i mbeturinave në dy zonat e synuara të projektit, rëndësia e krijimit të një sistemi eficient për menaxhimin e mbeturinave (reduktimi, ndarja, reciklimi) dhe në shkëmbimin e informatave dhe eksperiencave ndërmjet dy vendeve. Vëmendje e veçantë j'u kushtua mbrotjes së mjedisit dhe marrjes së informacionit mbi legjisllacionin dhe

standardet e BE-së në fushën e menaxhimit të mbeturinave.



Trajnim dhe praktikë për shërbimet e shpëtimit nga Mali i Zi dhe Shqipëria

Në kuadër të projektit "Fatkeqësitë Natyrore nuk njohin kufinj", zbatuar nga FORS në Malin e Zi në bashkpunim me Prefekturën Shkodër dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme të Malit të Zi -



Drejtorja e Emergjencave, u organizua një rast stimulimi për mbrotjen dhe shpëtimin në rast përbmytjesh me date 31 tetor në Podgoricë. Nga Mali i Zi dhe Shqipëria, 26 shpëtues (personel i ekipeve të ndërhyrjes së shpejtë) kontrolluan dhe demonstruan gadishmërinë e tyre për shpëtimin në rastet e përbmytjeve dhe ujrave të rrëmbyera në përputhje me Sistemin e Shpëtimit 3.

Ushtrimet u paraprinë nga një trajnim 4 ditorë që përfshiu pjesë teorike dhe praktike, gjatë të cilit pjesëmarrsit patën mundësi të mësojnë nga instruktorët bashkëkohor të shpëtimit malor nga Shërbimi i Shpëtimit Malor Kroat mbi metodat e reja të mbrotjes dhe shpëtimit në rastet e përbmytjeve dhe ujrave të rrëmbyeshëm.

Aktivitete në terren në Mal të Zi dhe Shqipëri

Muzeu Polimje në Mal të Zi në bashkpunim me Agjencinë e Zhvillimit Rajonal në Bjelasica, Komovi dhe Prokletije, Këshillin e Qarkut Shkodër dhe EuroPartners Development organizuan aktivitete në terren gjatë muajit gusht dhe shtator në kuadër të projektit "Ruajtja e peisazheve kulturore në Shqipëri dhe Mal të Zi".



Për këtë u vëzhguan shtëpitë e vjetra prej guri, shtëpitë prej dërrase/druri, mullinjët me ujë, stanet, gardhet rurale, në mënyrë që të mblihdhet informacioni i nevojshëm për një studim arkitekturorë i cili do t'i prezantojë këto stile tipike shoqëruar me mjaft foto dhe përshkrim të zgjeruar.



Të rinjtë për prodhimin e Mjadrës

Në Petnjicë, u mbajt ligjerata e dytë në temën "Shteti dhe perspektiva e kultivimit të mjadrës, prodhimi botërorë dhe rëndësia ekonomike".



Në këtë mënyrë, kjo ligjeratë shënoi fillimin e aktiviteteve në terren në kuadër të projektit "Të Rinjtë Malazet dhe Shqiptarë për kulturën e Lule Mjadrës" dhe fillimin e ligjeratave mbi kultivimin e mjadrës, kulturën e mjadrës e cila është prezente në zonën ndërkufitare ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë. Kjo praktikë do vazhdojë gjatë periudhës së ardhshme dhe më shumë ligjerata dhe aktivitete të tilla do të shoqërohen me punë praktike.


Rritja e kapaciteteve të shefave lokal në Shqipëri

Rritja e kapaciteteve të shefave lokal në Shqipëri u zhvillua si pjesë e aktiviteteve të projektit "Kuzhina lokale si ofertë turistike e

rajonit ndërkufitarë". Një sesion trajnimi me shefat e kuzhinës u organizua me datë 23 shtator të vitit 2018 në një restorant të zonës në Shqipëri. Ishin 5 shefa që morën pjesë në këtë trajnim pasi numri i restoranteve në këtë zonë në Shqipëri është i limituar. Trajnimi u drejtua nga ekspertët e Akademisë Gastronomike Shqiptare.



2018 në numra



» Strukturat Operuese të programit
klikoni tek ikona për të shkuar tek web -
faqja)



European Integration Office



Ministry of finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik
E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat
E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti me Specializim në Komunikim
E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti me Specializim në IT
E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ
E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri
Telefon: + 355 22 80 20 80;

Andi ÇEKAJ

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**
Adresa: Garibaldi 23/10, 10 000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: +383 38 222 202;

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian